



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANE SH.A. DREJTORIA E PROKURIMEVE



Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2018

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin Ekonomik "ALB-BUILDING" shpk, me NIPT J69102508C, me seli në Adresën: Njesia bashkiake Nr.9, Rruga Asim Vokshi, ndertesa nr.14, hyrja 4, apartamenti 6, kodi postar 1016.

Procedura e prokurimit: "Procedurë e hapur"

Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: "Spostim rrjet ujësjellësi nga Unaza deri në prog.1600, DN-800 dhe spostim rrjeti K.U.Z (Shtesa e Bulevardit "Zogu i I")"

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-89691-10-12-2018

Fondi limit: 64.974.808 (Gjashtëdhjetë e katër milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e tetëqind e tetë) lekë pa TVSH

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 4 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të tenderit është: 15.11.2018, 09:00

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr.42 të dates 22.10.2018

Njoftojmë se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1. Operatori ekonomik "ALB-BUILDING" shpk** J69102508C

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: **60.206.650** (gjashtëdhjetë milion e dyqind e gjashtë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

- 2. "ALEN - CO" Sh.p.k** K83213401M

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: **0 (zero) lekë pa TVSH**

Janë skualifikuar operatorët ekonomik për arsyet si më poshtë vijon:

- 1. Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik "ALEN - CO" Sh.p.k me vlerë të ofertës 0 (zero) lekë pa TVSH**

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria "ALEN-CO" sh.p.k

nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në Shtojcën 12, të dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “**ALEN-CO**” sh.p.k s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 12, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatoreve ekonomik “**ALB-BUILDING**” shpk me NIPT J69102508C, me seli në Adresën: Njesia bashkiake Nr.9, Rruga Asim Vokshi, ndertesa nr.14, hyrja 4, apartamenti 6, kodi postar 1016 me vlerë prej **60.206.650** (gjashtëdhjetë milion e dyqind e gjashtë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, se është **identifikuar si oferta e suksesshme**.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a me adresë rruga “5 Maji” pranë Medresesë, Tiranë, me nr tel: +355 4 2225572, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 16.11.2018.

Ankesa: Nuk ka